



Z. Benjamin SHKRELI
Rr.Lidhja e Lezhës
Vushtrri

Rasti Nr. 2018/173
Ref:1810/1132/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2018/173 Familja Shkreli (Palë Ankuese) kundër Ofruesit të Shërbimeve Mediale TE 7

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë KKPM-2016/3, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM, me datën 26 korrik 2018 ka pranuar një ankesë nga Familja Shkreli ndaj TE 7, për kronikën të transmetuar në edicion e lajmeve të orës 19:30, të transmetuar me datën 21 korrik 2018, përmes së cilës Familja Shkreli pretendon se TE 7 përmes kësaj kronike ka shkelur parimet profesionale dhe të kodit të gazetarisë, duke lejuar të transmetohet vetëm pala që pretendon të jetë viktimë, kurse gazetarja nuk merr mundin që t'i kontaktojë dhe të marr opinionin e anëtarëve të familjes Shkreli, duke bërë që pretendimet e paraqitura në këtë kronikë të jenë krejtësisht në mënyrë të njëanshme.
3. KPM, me datën 31 korrik 2018 nëpërmes një shkrese e ka njoftuar TE 7 për ankesën e pranuar nga Familja Shkreli dhe ka kërkuar sqarim lidhur me pretendimet e ankesës.
4. KPM, me datën 15 gusht 2018, ka kërkuar nga TE 7 që Palës ankuuese t'i ofrohet e drejta e reagimit në afat prej shtatë (7) ditësh pas pranimit të Njoftimit.
5. KPM, me datën 22 gusht 2018, ka pranuar një përgjigje nga TE 7 përmes së cilës i ka mohuar pretendimet e Palës Ankuese se ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/3, pasi që nuk ka pasur qëllim të animit të njëres apo palës tjetër të përfolur në kronikë dhe i ka lënë mundësinë e shprehjes dhe ka tentuar disa herë të kontaktojë me përfaqësuesit e palës ankuuese mirëpo ka qenë e pamundur.

6. KPM, me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore të Palës Ankuese, ka bërë monitorimin sërish të televizionit TE 7 dhe bazuar në raportin e monitorimit të datës 14 shtator 2018, ka gjetur se TE 7 nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, pasi që TE 7 përmes emisionit Frontal me datë 12 shtator 2018, ka transmetuar reagimin e Familjes Shkreli si dhe ka kërkuar falje publike familjes dhe personave të përmendur në kronikë.

Analiza Ligjore

7. Komisioni i KPM-së bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se TE 7 nuk është gjetur në shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
8. Komisioni i KPM-së pretendimet e Palës Ankuese i ka trajtuar në bazë të neneve të cekura në ankesë, në kuptimin e nenit 6 paragrafi 7 dhe nenit 10, paragrafi 1 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 6, paragrafi 7, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“OSHM-të duhet të ofrojnë prezantim të perspektivave të ndryshme në mënyre korrekte dhe të drejtë. Në qoftë se njëra palë refuzon që të ofrojë pikëpamjen e saj, publiku duhet të informohet për këtë refuzim.”

9. KPM-së në bazë të monitorimit dhe analizimit të kronikës *"Fqinjët në Vushtrri në hall me njëri-tjetrin"*, të transmetuar me datën 21 korrik 2018 në edicionin e lajmeve të orës 19:30 në TE 7, TE 7 nuk është gjetur në shkelje pasi që ka tentuar disa herë të kontaktojë z. Benjamin Shkreli, po i njëjti ka refuzuar të jep qëndrim lidhur me ngjarjen.

Nenin 10, paragrafi 1, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

“Me qëllim të korrektësisë dhe paanshmërisë duhet të ofrohet mundësia që brenda shtatë (7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetohet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë të njëjtë.”

10. KPM, në bazë të monitorimit dhe analizimit të kronikës *"Fqinjët në Vushtrri në hall me njëri-tjetrin"*, ka gjetur se TE 7 nuk gjetur në shkelje pasi që Palës Ankuese i është ofruar e drejta e reagimit dhe i është kërkuar falje publike familjes dhe personave të përmendur në kronikë.
11. KPM, bazuar në raportin e monitorimit ka gjetur se TE 7 nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03 gjatë transmetimit të kronikës me titull *"Fqinjët në Vushtrri në hall me njëri-tjetrin"* të transmetuar në edicionin e lajmeve orës 19:30 në TE 7.
12. Prandaj, KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, gjen se TE 7, kundër të cilës është ankuar Familja Shkreli nuk është gjetur në shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendimi

13. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se TE 7 nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03.
14. Komisioni i KPM-së, merr vendim që ankesën e Familjes Shkreli ta refuzojë si të pabazë, pasi që TE 7 nuk është gjetur në shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03.

E drejta për Ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysht vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim


Muja FERATI
Kryetar



29.10.2018
Datë